



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-149 për Ligjin e shërbimit Civil të Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, nenit 66.3 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 86 të Statutit të Komunës si dhe autorizimit të M.A.P-it më 23.01.2012 shpallë konkurs për plotësimin e vendit të lirë të punës:

TITULLI I VENDIT TË PUNËS:

I. ZYRTAR PËR PEMËTARI

Drejtoria për bujqësi, zhvillim rural dhe pylltari

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: (Koeficienti 6)

Numri i referencës së vendit të punës: 111-17512/11

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Mbledhë informata për lëminë e pemëtarisë
- Jep këshilla profesionale për mbrojtjen e pemëve nga sëmundjet, dëmtuesit dhe mirëmbajtjen e plantacioneve me pemë
- Harton projekte në lëminë e pemëtarisë
- Mbështetje fermerëve për kompletimin e dokumentacionit gjatë aplikimit në grante të pemëtarisë nga MBPZHR dhe shoqatat e ndryshme
- Punë të tjera sipas urdhërit të mbikëqyrësit

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar: përgatitje universitare – drejtimi: pemëtari- vreshtari

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkojnë:

- Të kenë aftësi komunikimi dhe profesionale në lëminë e caktuar
- Njohuri të mira në aplikimin e programeve Microsoft office (Excel, Word, Power point)
- Aftësi për përmbushjen e detyrave të punës
- Përvojë pune profesionale në lëmi të ngjajshme

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.

Kohëzgjatja e emërimit : Sipas ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores -**Zyra e pranimit**, kati përdhësë dhe në web-faqen komunale .

Kërkesat specifike: -Dëshmi mbi kryerjen e obligimeve komunale

Aplikacionit duhet t'i bashkëgjatjen edhe këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes si dhe certifikata tjera mbi trajnimet e kryera.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyren e personelit.

**Kryetari i Komunës
z. Xhabir Zharku**